



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-014
Prishtinë, më 25 dhe 26 janar 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 25 DHE 26 JANAR 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit: Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Slavko Simiq.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bekë Berisha, Driton Selmanaj, Zenun Pajaziti, Albin Kurti, Time Kadrijaj, Albulena Balaj-Halimaj, Xhevahire Izmaku dhe Naser Rugova, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Arbërie Nagavci i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me shkarkimin dhe emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me furnizimet me barna esenciale dhe trajtimet shëndetësore jashtë vendit.

Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Drita Millaku i parashtrroi pyetje Ministrin të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me impiantin e ujërave të zeza dhe zbulimet arkeologjike në fshatin Vlashje, Komuna e Prizrenit.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes..

Deputetja Drita Millaku i parashtrroi pyetje Ministrin të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me dëmtimin e zbulimeve arkeologjike në fshatin Vlashje, gjatë ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza në këtë fshat.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Valentina Bunajku-Rexhepi i parashtrroi pyetje Ministrin të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me ndërtimin e objektit për Operë dhe Balet.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Haxhi Shala i parashtrroi pyetje Ministrin të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, në lidhje me statusin dhe pajisjes me dokumente për qytetarët nga Medvegja, Bujanoci dhe Presheva të cilët jetojnë në Kosovë.

Ministri Flamur Sefaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Haxhi Avdyli i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje me gjendjen e shtratit të lumit Toplluha.

Ministrja Albena Reshitaj nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Armend Zemaj i parashtrroi pyetje Ministrin të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, në lidhje me gjendjen e sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë.

Ministri Flamur Sefaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Saranda Bogujevci i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me restaurimin e monumentit “Kulla e Demë Ahmetit” në Podujevë.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me realizimin e pensioneve për qytetarët e Kosovës që kanë punuar në Zvicër.

Ministri Skender Reçica iu përgjigje pyetjes së deputetes.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me zbatimin e Ligjit për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe të Ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Sami Kurteshi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbulimin e shpenzimeve për ekspertizë të pavarur ndërkombëtare lidhur me vdekjen e aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari.

Kryeministri nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me ndërtimin e rrugës magjistrale Pejë - Prishtinë”.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Mirjeta Kalludra i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, në lidhje me kompensimin e qytetarëve të cilët janë faturuar për energjinë elektrike që nuk e kanë shpenzuar, si dhe veprimet e ndërmarra për zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit për Energjinë.

Ministri Valdrin Lluka iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Mirjeta Kalludra i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, në lidhje me pagesat e shpenzimeve të ujit dhe të mbeturinave në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Ministri Valdrin Lluka iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtrroi pyetje ministrit të Administratës Publike, Mahir Jagcilar, në lidhje me procedimin në Kuvend të ligjit për pagat.

Ministri Mahir Jagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes.

* * *

Në vazhdim, kryetari i njoftoi deputetët me propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin që rendi i ditës i seancës plenare të plotësohet edhe me një pikë - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme dhe i njëjti të bëhet me shmangien nga afatet procedurale.

Kryetari kërkoi deklarinimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartcekur të kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Në lidhje me propozimin e lartcekur diskutuan: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së, Avdullah Hoti në emër të GP të LDK-së, Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së, Ahmet Isufi në emër të GP të AAK-së dhe Sasha Milosavljeviq, në emër të GP të Listës serbe, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin për plotësimin e rendit të ditës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër -----0,
Abstenime -----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash vendosi që shqyrtimi i dytë të Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme të bëhet në seancën e sotme, me shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 15, paragrafi 7 dhe me nenin 57, paragrafi 9 të Rregullores së Kuvendit.

* * *

Kryetari i Grupit Parlamentar të LVV-së, Glauk Konjufca, propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika e 15 - Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026. Diskutimi i z. Konjufca është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e paraqitur nga z. Konjufca.

Lidhur me propozimin e lartshënuar, të parashtruar nga kryetari i Grupit Parlamentar të LVV-së diskutuan: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP të Listës serbe; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së dhe deputetja Sala Berisha-Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre deklarinimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LVV-së, Glauk Konjufca.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 24,
Kundër -----34,
Abstenime -----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të LVV-së, Glauk Konjufca për heqjen nga rendi i ditës të pikë së 15 - Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme, të mbajtur më 22 dhjetor 2017.

4. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtje me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin Ramush Haradinaj, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtje me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Meqë mungonte kryeministri, kjo pikë e rendit të ditës me kërkesë të propozuesit të interpelancës u shty për kohën kur kryeministri do të jetë i pranishëm në sallë.

5. Shqyrtimi i propozim-Rezolutës për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm - Agjenda 2030 për Kosovën

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e ka parashtruar një mocion për propozim-Rezolutë për miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm - Agjenda 2030 për Kosovën.

Ai e ftoi kryetaren e Komisionit FunkSIONAL që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë propozim-Rezolutën.

Kryetarja e Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Besa Baftiu, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen e propozim-Rezolutës. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë Rezolutën e propozuar. Diskutimi i saj është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin për rezolutën e propozuar.

Lidhur me propozim-Rezolutën për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm – Agjenda 2030 për Kosovën, diskutuan, deputetët: Fatmire Kollçaku, në emër të GP të LVV-së; Haxhi Avdyli, në emër të GP të LDK-së; Flora Brovina në emër të GP të PDK-së dhe Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim propozim-Rezolutën për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm - Agjenda 2030 për Kosovën.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër -----0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

REZOLUTË
për miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm

1. Miratohen Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (ose Agjendën 2030) bazuar në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme A / RES / 70/1 të miratuar nga 193 liderë nga mbarë bota më 25 shtator 2015, dhe të lidhura me Deklaratën e Konferencës Botërore të Kryetarëve të Parlamenteve si pikat kryesore të referencës mbi të gjitha politikat për zhvillim të qëndrueshëm;
2. Do të angazhohet për të ndihmuar zbatimin e kësaj kornize të re globale nëpërmjet miratimit të legjislacionit, duke përfshirë edhe miratimin në kohë të buxhetit të nevojshëm;
3. Rishikon kur është e nevojshme strukturën ekzistuese të komisioneve dhe të gjitha proceset e brendshme ashtu që në mënyrë efektive dhe koherente të përfshihen të gjitha Objektivat relevante përmes Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision kryesor, dhe Komisionet tjera relevante që përfshijnë: Komisionin Parlamentar për Integrimin në BE, Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Planifikimit Hapësinor, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
4. Do të përcjellë zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Qeverisë për Zhvillim, strategjive të integritit në BE dhe strategjive të tjera që integrojnë OZHQ-të, duke përfshirë mbajtjen e takimeve të rregullta me shoqërinë civile, sektorin privat dhe qytetarët në përgjithësi;
5. Kërkon nga Qeveria raportim mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit (2016-2021), duke përfshirë edhe rreth objektivave të OZHQ-ve përmes një rishikimi të plotë vjetor nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
6. Shqyrton raportet kombëtare të progresit që do të mund të paraqiten nga Qeveria në Kombet e Bashkuara si pjesë e shqyrtimit global në Forumin e Nivelit të Lartë të OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm;
7. Organizon, në fund të çdo viti, mbledhje me Qeverinë, komunitetin ndërkombëtar, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët në përgjithësi, për debat publik rreth statusit të progresit të Synimeve relevante të OZHQ-ve për zhvillimin e vendit tonë;
8. Kjo Rezolutë hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i parë i Projekt-Kodit të drejtësisë për të mitur

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projekt-Kodin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projekt-Kodit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projekt-kod.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projekt-kodi.

Lidhur me Projekt-Kodin e drejtësisë për të mitur diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Igor Simiq, në emër të GP të Listës serbe, dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projekt-Kodin e drejtësisë për të mitur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projekt-Kodi nr. 06/L-006 i drejtësisë për të mitur.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projekt-Kodin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Financa, Bedri Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike diskutuan deputetët: Driton Selmanaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe në emër të GP të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Mërgim Lushtaku, në emër të GP të PDK-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së dhe Milaim Zeka, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 1,
Abstenime -----1.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Danush Ademi, në emër të GP “6+”, Sami Kurteshi dhe Ismajl Kurteshi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 45,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 16.

Kuvendi me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje diskutuan deputetët: Daut Haradinaj, në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe në emër të GP të AAK-së; Liburn Aliu, në emër të GP të LVV-së; Besa Gaxherri, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së;

Albulena Balaj-Halimaj në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, dhe Danush Ademi, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ministri i Financa, Bedri Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080 diskutuan deputetët: Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe në emër të GP të LDK-së; Ali Lajçi, në emër të GP të LVV-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Slavko Simiq, në emër të GP të Listës Serbe; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Haxhi Shala, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Danush Ademi, në emër të GP të “6+”, Armend Zemaj dhe Naser Rugova, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi, në mungesë të kuorunit, i ndërpreu punimet e seancës në orën 18:10 minuta.

* * *

E premte, më 26 janar 2018

Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 25 janar 2018

Seancën plenare e kryesoi kryetari i Kuvendit Kadri Veseli, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala.

Kryetari procedoi me këtë rend dite:

4. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtje me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin Ramush Haradinaj, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtje me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

Ai gjithashtu i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryetari e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti Armend Zemaj, nga Grupi Parlamentar i LDK-së, tha se kryeministri është thirrur në interpelancë për të dhënë sqarime mbi pamjet e shfaqura në media të zyrtarëve të lartë qeveritar, një ndër ta zëvendëskryeministër dhe njëkohësisht ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike duke përdorur armë zjarri dhe në këtë mënyrë kanë vënë në rrezik jetën dhe shëndetin publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ai tha se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkon përgjegje të prerë nga Qeveria dhe Kryeministri Haradinaj, ndaj skenave të publikuara, ku Ministri dhe zv. Kryeministri i Kosovës, Dardan Gashi, në prani dhe pjesëmarrje edhe të zyrtarëve tjerë qeveritar, nëpërmjet veprimeve të tij me gjuajtje me armë ka bërë rrezikim të përgjithshëm të jetës së njerëzve, ngase në shtetin e së drejtës autoritet e atij vendi jo vetëm që respektojnë legjislacionin dhe organet e sigurisë, por edhe janë shembull i mirë në sjelljen ndaj tyre.

Gjithashtu, z. Zemaj, në emër të propozuesit të interpelancës, e paraqiti tekstin e mocionit për votim, si në vijim:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, kërkon përgjegjësi nga Qeveria e Kosovës, karshi këtyre veprimeve të rrezikshme dhe me shkelje të rënda ligjore, vepra të tilla të dënueshme edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës (nenin 374. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve dhe nenit 375. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm)

2. Kërkojmë menjëherë shkarkimin e zv.kryeministrit, njëherësh ministrit të Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi.

Më pas, kryetari e ftoi kryeministrin e Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e ngritur për interpelancë.

Kryeministri i njoftoi deputetët se për lëndën për të cilën është thirrur interpelanca, Policia e Kosovës ka intervistuar pesë persona në këtë lëndë, ndër ta edhe zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Gashi.

Ai deklaroi se nuk është e hijshme në shekullin XXI, t'i ekspozohet as publikut, as njerëzve me gjuajte me armë, por po ashtu, nëse duam të flasim pak realisht për jetën tonë, ende janë disa tradita që nuk janë zhdukur krejtësisht, dhe tani jemi në atë periudhën kur ne të gjithë dakordohemi që t'u japim përparësi ligjeve në fuqi, Kushtetutës së vendit dhe të sillemi në përputhje me obligimet që kemi.

Kryeministri tha se kërkesa për masa tjera është e hershme, për çfarëdo mase ndaj cilitdo të përfshirë, dhe nuk parashihet të avancojmë ne me veprimet tjera përdërisa ky rast është në proces ligjor.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e kryeministrit Ramush Haradinaj.

Për interpelancën e kryeministrit, diskutuan deputetë: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Vjosa Osmani-Sadriu, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të "Nisma për Kosovën"; Albert Kinolli, në emër të GP "6+"; Drita Millaku, Lumir Abdixhiku, Zenun Pajaziti, Teuta Haxhiu, Sami Kurteshi, Haxhi Avdyli, Hajdar Beqa, Fatmire Kollçaku, Korab Sejdiu, Nait Hasani, Time Kadrijaj, Enver Hoti, Rexhep Selimi, Mimoza Kusari-Lila, Shkumbin Demaliaj, Milaim Zeka, Albin Kurti, Driton Selmanaj, Saranda Bogujevci, Ilir Deda, Arbër Rexhaj, Xhelal Sveçla, kryeministri Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe ministri Flamur Sefaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e tekstit të mocionit të propozuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 36,
Kundër ----- 49,
Abstenime ----- 3.

Kuvendi nuk e miratoi tekstin e mocionit të propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

10. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë Projektligj kanë përfunduar një ditë më parë, por në mungesë të kuorumit nuk është proceduar me votimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime -----19.

Kuvendi me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Punëve të Brendshme Flamur Sefaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për azil diskutuan deputetët: Haxhi Shala, në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Sami Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Fatmir Xhelili, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bahrim Shabani, në emër të GP të “6+”; Islam Pacolli dhe Arbër Rexhaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për azil.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 82,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-026 për azil.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për standardizim

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për standardizim dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Sala Berisha-Shala, kryetare e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit. Diskutimi i saj është dhënë i plotë në transkript.

Në këtë projektligj ishin paraqitur gjithsejtë 19 amendamente.

Kryetari me pëlqimin e deputetëve i hodhi në votim amendamentet nga 1-19 përnjëherë.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19.

Më pas, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 71,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 3.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-019 për standardizim.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 28 amendamente.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim në formë elektronike përnjëherë vetëm amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL dhe deputetja Evgjëni Thaçi-Dragusha me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL në këtë projektligj.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 23, 24, 27, 28.

Ndërsa, Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 6, 9, 10, 11, 12, 22, 25 dhe 26.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 69,
Kundër -----10,
Abstenime ----- 7.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin vjetor të

Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryetarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Sala Berisha-Shala, e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin e Komisionit Funkcional lidhur me raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016. Diskutimi i saj është dhënë në transkript.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin e komisionit lidhur me raportin financiar të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin për raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016.

Lidhur me raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016 diskutuan deputetët: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Sala Berisha-Shala, në emër të GP të PDK-së dhe ministri Valdrin Lluka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 47,
Kundër -----18,
Abstenime ----- 6.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasni, e paraqiti dhe e arsyetoi rekomandimin e Komisionit FunkSIONAL lidhur me raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për raportin e lartshënuar.

Lidhur me raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016, diskutuan deputetët: Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV-së; Xhevahire Izmaku në emër të GP të PDK-së; Rasim Selmanaj, në emër të GP të AAK-së dhe Milaim Zeka, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----56,
Kundër----- 4,
Abstenime-----5

Kuvendi me shumicë votash mori:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016

16. Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen e kësaj Strategjie. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë Strategjinë e propozuar. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026.

Lidhur me Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026, diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit FunkSIONAL dhe në emër të GP të PDK-

së; Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Daut Haradinaj, në emër të GP të AAK-së; Miljana Nikoliq në emër të GP të Lista serbe; Milaim Zeka, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, dhe Islam Pacolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 47,
Kundër -----17,
Abstenime ----- 9.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Strategjia e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026.

19. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare

Kryesuesi i njoftoi deputetët me propozimet e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të AAK-së, për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimet e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të AAK-së.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 06-V-006

I. Vendimi nr. 06-V-006, datë 3 tetor 2017, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Deputeti Nezir Çoçaj, nga Grupi Parlamentar i PDK-së, emërohet anëtar në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, në vend të ish-deputetit Agim Aliu.

2. Deputeti Muharrem Nitaj, nga Grupi Parlamentar i AAK-së, emërohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në vend të deputetit Blerim Kuçi.

20. Propozimi për emërimin e tre (3) anëtarëve në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komunisteve dhe për Kthim

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit e ka proceduar për në seancë plenare Propozim-Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 006, datë 3. 10. 2017, pika I.b).

Ai tha se ky propozim-vendim u është shpërndarë deputetëve.

Kryesuesi, kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për Propozim-Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 006, datë 3. 10. 2017, pika I.b).

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 06-V-006, 3 tetor 2017

1. Pika I.b. e Vendimit për formimin e komisioneve parlamentare nr. 06-V-006, datë 3 tetor 2017, ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

1.1. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim plotësohet edhe me tre (3) anëtar: deputeti Haxhi Shala, nga komuniteti shumicë (GP i “Nisma për Kosovën”), deputeti Slobodan Petroviq, nga komuniteti serb, dhe deputeti Veton Berisha, nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.

17. Përzgjedhja e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi propozoi që të procedohet përnjëherë me votimin e fshehtë për pikat e rendit të ditës: Përzgjedhja e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Zgjedhja e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Deputetët e mbështetën propozimin e Kryesuesit z. Haliti, që Kuvendi përnjëherë të procedoi me votimin e fshehtë të dy pikave të rendit të ditës: Përzgjedhja e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Zgjedhja e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Pastaj, kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa që para deputetëve të Kuvendit ta paraqes raportin e Komisionit dhe të sqarojë procedurën e votimit të fshehtë.

Lumir Abdixhiku, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin e Komisionit FunkSIONAL për përzgjedhjen e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e Komisionit Funkcional.

Deputetja Lirije Kajtazi para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin e Komisionit Funkcional për zgjedhjen e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Pastaj, kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare, që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Saranda Bogujevci, GP, LV,
Mirjeta Kalludra, GP, LDK,
Ganimete Musliu, GP, PDK,
Rasim Selmanaj, GP, AAK,
Adem Hoxha, GP, LS,
Milaim Zeka, GP “Nisma” dhe
Bahrim Shabani, GP “6+”.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues, që të fillojnë me procedurat e votimit të fshehtë për pikat e rendit të ditës: 17) *Përzgjedhja e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe 18) Zgjedhja e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit.*

Pastaj, kryetari i ftoi sipas listës deputetët e Kuvendit për të votuar.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për përzgjedhjen e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës e paraqiti deputetja Ganimete Musliu.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kishin marrë pjesë 95 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 3 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

1. Bedri Peci, 31 vota,
2. Flamur Mrasori, 36 vota dhe
3. Genc Rraci, 25 vota.

Komisionit votues konstatoi se asnjëri nga kandidatët nuk është kualifikuar në këtë rund të votimit, prandaj dy kandidatët të cilët kanë marrë numër më të madh të votave, e që në këtë

rast janë Bedri Peci me 31 vota dhe Flamur Mrasori me 36 vota, shkojnë në rundin e dytë të votimit.

Ndërsa, rezultatit e votimit për zgjedhjen e pesë zëvendës-Avokatëve të Popullit e paraqiti anëtarja e komisionit votues, deputetja Saranda Bogujevci.

Në votim kishin marrë pjesë 95 deputetë prej tyre 8 fletëvotime ishin të pavlefshme. Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një pozitë të zëvendës-Avokatit të Popullit nga radhët e gjinisë femërore ishin:

1. Majlindë Sinani-Lulaj, 72 vota dhe
2. Afërdita Rexhaj, 15 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një pozitë të zëvendës-Avokatit të popullit nga radhët e komuniteteve jo-shumicë ishin:

1. Aleksandra Dimitrijeviq, 40 vota dhe
2. Marija Raduloviq, 48 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për tri pozita të zëvendës-Avokatit të Popullit ishin:

1. Albert Avdiu, 38 vota,
2. Murlan Prizreni, 5 vota,
3. Mehdi Geci, 61 vota,
4. Basri Berisha, 20 vota,
5. Baki Svirca, 9 vota,
6. Naile Alaj, 34 vota dhe
7. Edona Hajrullahu, 58 vota.

Në rundin e dytë shkojnë kandidatët: Albert Avdiu dhe Naile Alaj, me numër më të madh të votave.

Pastaj, Kryesuesi i ftoi deputetët një nga një të votonin në raundin e dytë për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe një zëvendësi të Avokatit të Popullit.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit, në emër të Komisionit votues rezultatit e votimit e paraqiti deputetja Ganimete Musliu.

Rezultati i votimit ishte:

- Në votim kishin marrë pjesë 87 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 5 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Flamur Mrasori, 48 vota dhe
2. Bedri Peci, 34 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit në raundin e dytë dhe në mbështetje të neneve 65 (9) dhe 140 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 67 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

1. Z. Flamur Mrasori zgjidhet anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Vendimi i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

* * *

Ndërsa, rezultatin e votimit të raundit të dytë për zgjedhjen e një zëvendës-Avokati të Popullit e paraqiti deputetja Saranda Bogujevci.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kishin marrë pjesë 87 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 5 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një pozitë të zëvendës-Avokatit të Popullit ishin:

1. Albert Avdiu, 36 vota dhe
2. Naile Alaj, 46 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim të neneve 65 (9) dhe 133 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 67 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 10 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit

I. Kuvendi zgjodhi zëvendësit e Avokatit të Popullit, si në vijim:

1. Znj. Majlindë Sinanaj-Lulaj zgjidhet zëvendës i Avokatit të Popullit, nga radhët e gjinisë femërore,

2. Znj. Marija Radulović zgjidhet zëvendës i Avokatit të Popullit, nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë,
3. Z. Mehdi Geci zgjidhet zëvendës i Avokatit të Popullit,
4. Znj. Edona Hajrullahu zgjidhet zëvendës i Avokatit të Popullit,
5. Znj. Naile Alaj zgjidhet zëvendës i Avokatit të Popullit.

II. Mandati i zëvendësve të zgjedhur të Avokatit të Popullit, sipas pikës I të këtij vendimi, zgjatë (3) tre vjet.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 18:35.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*